




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **20.03.2013**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-443/13, për ztr. *Bashkim Stavileci* – *Ish Udhëheqës në Sektorin e Auditimit në Doganat e Kosovës, për shkak se ai tashmë nuk e ushtron këtë funksion dhe nuk ka situatë të konfliktit të interesit.***

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-443-13, për Zyrtarin e lartë, ztr. Bashkim Stavileci – Udhëheqës në Sektorin e Auditimit në Doganat e Kosovës, dhe njëkohësisht njëri nga personat e autorizuar të një biznesi privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Në rastin me numër protokoli AKK-03-4803/11, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari të lartë, ztr. Stavileci i është dërguar njoftimi me një shkresë zyrtare nga Agjencia, pas të cilës zyrtari kontaktues nga Doganat e Kosovës, na ka dërguar një shkresë njoftuese (PKI-03-658/13), në të cilat ka njoftuar se, tashmë, ish zyrtari i lartë ztr. Bashkim Stavileci nuk është më zyrtar i Doganës së Kosovës, dhe rrjedhimisht nuk është as në listën e zyrtarëve të lartë.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se nuk ka situatë të konfliktit të interesit pasiqë ztr. Stavileci tashmë nuk ushtron funksionin si zyrtar publik në “Doganat e Kosoves”.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore Agjencisë Kundër Korrupsionit

\_\_\_\_\_  
/ Hasan Preteni /

